



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.03, datë 27.07.2022

**“PËR
MIRATIMIN E KORRIGJIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA SARANDË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 3, DATË 16.10.2017,
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, I RISHIKUAR”**


Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 2 dhe 10 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 3, datë 16.10.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Sarandë”, i rishikuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Sarandë, të miratuar me Vendim Nr. 3, datë 16.10.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, i rishikuar, të bëhen korrigjime në dokumentin e:
 - *Rregullores së Planit, në Tabelën e Treguesve të Zhvillimit:*
 - *Në pasaportën e njësisë strukturore KS.ZU.157;*
 - *Në pasaportën e njësisë strukturore KS.N.158;*
 - *Në pasaportën e njësisë strukturore KS.N.486;*
 - *Në pasaportën e njësisë strukturore KS.N.496;*
 - *Shtohet njësia strukturore KS.ZU.502;*
 - *Shtohet njësia strukturore KS.ZU.503.*

sipas Dokumentit të Korrigjimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Sarandë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohet Bashkia Sarandë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentet shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.



Ngarkohen Bashkia Sarandë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

